



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KRYETARI

Nr. 10455 prot.

Korçë më, 07 / 11 / 2019

**URDHËR**

Nr. 873, datë 07 / 11 / 2019

**Për një shtesë në urdhërin nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar**

Pasi shqyrtova relacionin e datës 04.11.2019, paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit, lidhur me oraret e funksionimit dhe stacionet e qëndrimit të linjës të rregullt rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve Gjonomadh-Korçë-Gjonomadh, mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 64, pika b; vendimi i Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 17, datë 03.03.2017, pika 2, "Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar;

**URDHËROJ:**

1. Në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, për Njësinë Administrative Voskopojë, kryhet shtesa për linjën Gjonomadh-Korçë-Gjonomadh, oraret e nisjes e kthimit dhe stacionet e qëndrimit do të jenë si më poshtë:

1.	LINJA NR. 7/2	Gjonomadh-Korçë-Gjonomadh
2.	Oraret e nisjes	07 <sup>05</sup> , 08 <sup>30</sup> , 13 <sup>30</sup> , 15 <sup>30</sup> .
3.	Oraret e kthimit	07 <sup>35</sup> , 12 <sup>10</sup> , 14 <sup>15</sup> , 16 <sup>20</sup> .
4.	Stacionet	Gjonomadh & Korçë.

2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake Korçë .
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi

N. Lika

Drejtoria Juridike

A. Dishnica

**KRYETARI**

**Sotirag Filo**

